

REPUBLIKA E KOSOVES		AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
DPR/DMP		03-4312/12	
02		30.11.2012	

Nr. Regj. 14833/2012

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, gjyqtaria Azra Cakolli me pjesëmarrjen e sekretares juridike Shemsije Lumi, duke vendosur në procedurën për kundërvajtje kundër të pandehurës Valbona(Xhevdet)Petrovci, nga Prishtina, për kundërvajtje nga neni 8 lidhur me nenin 5.1 dhe 6.2 ndëshkuar me nenin 17 paragrafi 1 pika 1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat Zyrtarë, Nr. 04/L-050, në bazë të nenit 73, 74, 195, 199 dhe 198 paragrafi 1 pika 8 të Ligjit mbi Kundërvajtjet(LK) GZ KSAK 23/79, më datë 19.11.2012 morri këtë:

AKTVE N D I M

PEZULLOHET: Procedura për kundërvajtje ndaj **Valbona(Xhevdet)Petrovci**, e lindur më 03.07.1958 në Mitrovicë, me vendbanim në rrugën “Nazim Gafuri”, nr. 37, në Prishtinë, ka kryer kualifikimin superior, Prodekane e Degës së Artit Muzikorë, për kundërvajtjen nga neni 8 lidhur me nenin 5.1 dhe 6.2 ndëshkuar me nenin 17 paragrafi 1 pika 1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat Zyrtarë, **konform nenit 198 paragrafi 1 pika 8 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, për shkak se nuk ka prova se e pandehura ka kryer kundërvajtjen e cila me kërkesë i vihet në barrë.**

Shpenzime të procedurës nuk ka pasur.

Nga një kopje të këtij aktvendimi ti dorëzohet palës dhe parashtruesit të kërkesës.

A r s y e t i m

Agjencia Kundër Korrupsion në Prishtinë, i parashtrroi kësaj gjykate kërkesën Nr. 01-1610/2012 me datë 02.05.2012 për fillimin e procedurës për kundërvajtje ndaj të pandehurës Valbona Petrovci, për kundërvajtje nga neni 8 lidhur me nenin 5.1 dhe 6.2 ndëshkuar me nenin 17 paragrafi 1 pika 1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat Zyrtarë, me të cilën kërkesë i vihet në barrë se në Agjencinë Kundër Korrupsion, nuk e ka dorëzuar formularin mbi deklarin e rregullt vjetor të pasurisë deri më datën 31 mars të vitit 2012.

Gjyqtaria filloi procedurën kundërvajtëse me marrjen në pyetje të pandehurës e cila në mbrojtjen e vet deklaroi se nuk ka qenë e informuar nga askush, as në mënyrë elektronike nuk i ka ardhur asnjë i-mail për deklarin të pasurisë, andaj nuk e ka deklaruar pasurinë për vitin 2012. Ka propozuar të dëgjohet pika kontaktuese dhe dorëzuesi i tyre.

Për vërtetimin e gjendjes faktike gjyqtaria ftoi Shefki Krasniqin, sekretarin e Fakultetit të Arteve, i cili ka deklaruar se nga pika kontaktuese Fidan Halimi është informuar që zyrtarët e lartë brenda afatit ligjor deri 31. mars duhet ta bëjnë deklarin e pasurisë dhe formularin e ka shkarkuar pastaj ia ka dhënë Besim Pllanës, dorëzuesit me ia dërguar prodekanëve në mes tyre dhe prodekanës Valbona Petrovcit, por pasi që e njëjta nuk ka qenë në zyrë ai e ka vendosë në rreze të derës. Poashtu u dëgjua dhe dorëzuesi Besim Pllana, i cili deklaroi se sekretari i fakultetit ia ka dhënë formularët dhe se ai i ka vendosë në derë pasi dera e prodekanës ka qenë e mbyllur, por nuk e ka regjistruar këtë dorëzim në fletoren interne, duke menduar se ajo do ta gjen formularin kur të vjen në zyrë, andaj nuk ka provë për ta prezantuar se të njëjtës ia ka dorëzuar.

Ushtuesi i kërkesës Agjencia kundër korrupsionit në shkresat e lëndës ka bashkëngjitur kopjen e informimit përmes i-meillit, ku është informuar pika kontaktuese Fidan Halimi.